



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.676/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lista e Pavarur – Bekim Jashari me seli në Skenderaj, paraqitur për shkak të parregullsive në vendvotimin 2101X/05R, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

## **VE N D I M**

**I. PRANOHET** pjesërisht e bazuar ankesa Anr.676/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur për shkak të parregullsive në vendvotimin 2101X/05R, ashtu që **I NDALOHET** Altin Shabanit me numër personal [REDACTED], Kryesues i Vendvotimit 2101X/05R, në Skenderaj, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes së vendimit.

**II. REFUZOHET** e pabazuar, pjesa e ankesës me të cilën ka kërkuar që të përsëritet votimi, në Vendvotimin 2101X/05R.

## **A r s y e t i m**

Me datën 18.10.2021 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari me seli në Skenderaj, në të cilën pretendon se në vendvotimin 2101X/05R, gjatë numërimit të votave është evidentuar një (1) fletëvotim i pa vulosur të cilin anëtarët e KVV-së e kanë evidentuar në librin e shënimeve. Parashtruesi i ankesës kërkon që të përsëritet votimi në këtë vendvotim. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratën e Mirlinda Bajraktarit vëzhgueses nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

## **Ankesa është pjesërisht e bazuar**

PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura, konstatoi se ankesa është pjesërisht e bazuar në pjesën që ka të bëjë se në vendvotimin lëndor është një fletëvotim i pavulosur, kjo është konstatuar nga shkresat e ofruara nga Komisioni Qendror. Andaj në raport me këto parregullsi paneli vendosi si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”*. Lëshimet e pretenduara dhe te konstatuara nga paneli i atribuohen përgjegjësisë se kryesuesit të vendvotimit sipas nenit 74.10, pasi integriteti i procesit mbetet përgjegjësi e kryesuesit. *Me nenin 74.10 të LZP-së përcaktohet “ KVV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja”*.

Në raport me pjesën refuzuese për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli vlerëson se mospërputhja e konstatuar si më lart nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindës se ka pas parregullsi të asaj natyre për të ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, siç është vendosur në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga arsyet e lartcekura paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.676/2021 më datën 20.10.2021.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.